



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

RELACION

PËR

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 34, datë 29.02.2024”

Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54/dh; Ligjin nr. ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjin 97/2023, datë 07.12.2023, "Për Buxhetin e vitit 2024"; Udhëzimin Nr. 83 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të projekt buxhetit afatmesëm”, I ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë si dhe në Vendimi I Këshillit të Bashkisë Nr. 34, datë 29.02.2024 “Për Përcaktimin e Prioriteve të Investimeve për Vitet 2024 - 2026”, propozon ndryshimin si më poshtë:

Në pikën **B. Arsimi.**

1. Rikonstruksionin e objekteve arsimore:

- Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, me vlerë nga **69 000 000** lekë të ndryshojë në **71 241 573** lekë.

Kjo pasi nga Ministria e Arsimit dhe Sportit ku aplikuaam, për thirrjen për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin, u shpallëm fitues me vlerën **71 241 573** lekë.

Drejtor i D.P.K.ZH.T.

Urb. Zhaneta LUBONJA

Drejtoreshë e Dr. së Përgjithshme
Juridike dhe e Menaxhimit të
Burimeve Njerëzore

Anxhela (DISHNICA) QERAMIXHI

SOTIRAQ FILO

KRYETAR I BASHKISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____ .03.2024

PËR

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 34, datë 29.02.2024”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 54/dh; Ligjin nr. ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin 68/2017 "Për Financat e vetëqeverisjes vendore"; Ligjin 97/2023, datë 07.12.2023, "Për Buxhetin e vitit 2024"; Udhëzimin Nr. 83 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të projekt buxhetit afatmesëm”, i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë si dhe në Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr. 34, datë 29.02.2024 “Për Përcaktimin e Prioriteve të Investimeve për Vitet 2024 - 2026”, dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

- I. Të miratojë (të mos miratojë) ndryshimin në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 34, datë 29.02.2024 “Për Përcaktimin e Prioriteve të Investimeve për Vitet 2024 - 2026”, si më poshtë:

Në pikën B. **Arsimi.**

- Rikonstrukcionin e objekteve arsimore:
 - Rikonstrukcion i Shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, me vlerë nga **69 000 000** lekë të ndryshojë në **71 241 573** lekë.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës e të tjera, Drejtoria e Kontrollit të Territorit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1845/13 Prot.

Tiranë, më 14.03.2024

Lënda: Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin.

BASHKISË Korçë

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të nenit 15, ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", urdhrin nr. 97, datë 08.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, me cikël financimi 2024-2025, nga programet "Arsimi Bazë", "Arsimi i Mesëm" dhe programi "Për Sportin", për infrastrukturën shkollore e sportive", ju bëjmë me dije se jeni shpallur fitues për projektin/ projektet bashkëlidhur.

Konform legjislacionit të sipërcituar si dhe bazuar në:

1. Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014, i ndryshuar, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".
2. Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin e disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
3. Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje, kolaudim".
4. Vendimin nr. 319, datë 12.04.2017, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e standardeve të projektimit të shkollave", i ndryshuar.
5. Vendimin nr.216, datë 13.04.2023, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim".
6. Vendimin nr.537, datë 08.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave".
7. Vendimin nr.26, datë 15.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara".
8. Vendimin nr.887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike".

Pas miratimit të çeljes së fondeve nga Ministria e Financave, bashkia duhet të fillojë procedurat për realizimin dhe përmbushjen në afat të detyrimeve dhe pas realizimit të procedurave të prokurimit një kopje e kontratës së nënshkruar duhet të përcillet zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTRI



NINA GUGA

[Signature]

Nr.	Bashkia	Programi Buxhetor	Emërtimi i Projektit	Vlera e Plotë e Projektit	Financim nga NJQV	Financimi nga MAS 2024	Financimi nga MAS 2025
1	Korce	9120	Rikonstrukcion shkolles 9-vjecare "Sevasti Qirjazi", Korce	71,241,573	14,248,315	16,000,000	40,993,258
				71,241,573	14,248,315	16,000,000	40,993,258